

VENDIM
Nr. 232, datë 30.9.2025

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 13, DATË 31.1.2019,
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘RTS’ SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME FUQI TË
INSTALUAR 2 mw, NË FSHATIN TREN, BILISHT TË RRETHIT KORÇË”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.9.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2524 prot., datë 26.9.2025, të Drejtorisë së Politikave të Burimeve të Rinovueshme, “Mbi disa ndryshime në vendimmarrjet e Bordit të ERE-s lidhur me plotësimin e kushteve nga subjektet e licencuara në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “RTS” sh.p.k.

- Me vendimin nr. 13, datë 31.1.2019, Bordi i ERE-s ka licencuar shoqërinë “RTS” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 mw, në fshatin Tren, Bilisht, rrethi Korçë, për një afat 25-vjeçar.

- Në vendimin nr. 13/2019, në pikën 2 është përcaktuar se: “Subjekti ‘RTS’ sh.p.k., në përfundim të afatit 20-vjeçar të kontratës së qirasë, të lidhur me Bashkinë Devoll, të paraqesë në ERE kontratën e rinovuar.”.

2. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Pas ndryshimeve të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 220, datë 1.9.2022, në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, është riformatuar neni 9 i rregullores “Formati dhe dokumentacioni për aplikim”, duke shfuqizuar germen “g”, të pikës 2 të këtij neni, e cila përcaktonte se në dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor të paraqitur për aplikim përfshihen dhe dokumentet që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shitblerjeje, kontrata qiramarrjeje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerjeje, marrëveshje me subjekte që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti për ato veprimtari që përdorin asete për kryerjen e aktivitetit të licencuar).

- Në këto kushte, pika 2 e vendimit nr. 13/2019, që lidhet me depozitimin e kontratës së qirasë së rinovuar, nuk gjen më mbështetje në kuadrin rregullator dhe duhet të shfuqizohet.

- Heqja e kushteve nuk përjashton këtë shoqëri nga detyrimi për të ruajtur në vazhdimësi të drejtën e ligjshme të përdorimit të territorit ku shtrihet veprimtaria e licencuar, në përputhje me kontratat përkatëse ose aktet e pronësisë.

- Në përputhje me nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, shfuqizimi i pikës 2 është i domosdoshëm për të harmonizuar vendimin me kuadrin ligjor dhe rregullator të përditësuar, duke garantuar qartësi dhe koherencë në kushtet e licencës së shoqërisë.

3. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Ndryshimi është i nevojshëm për të shmangur pasiguritë ligjore dhe për të siguruar koherencë të vendimit me kuadrin rregullator aktual.

- Shfuqizimi i pikës 2 është i domosdoshëm pasi detyrimi i parashikuar në të nuk gjen më mbështetje në kuadrin rregullator dhe nuk përbën më një kusht të vlefshëm.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 13, datë 31.1.2019, shfuqizohet.

2. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë shoqërinë “RTS” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “FTL” sh.a. dhe “OSSH” sh.a. lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti